



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GJIROKASTËR  
DREJTORIA JURIDIKE DHE E PROKURIMEVE PUBLIKE  
SEKTORI JURIDIK

Nr 3130 Prot

Gjirokaštër më 07/04 / 2025

VENDIM

Nr. 31 Datë 07/04 / 2025

**PËR PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE NË TERRITORIN E BASHKISË  
GJIROKASTËR PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE E  
EDUKUESE DHE RREGULLAT PËR AFISHIMIN E TYRE GJATË FUSHATËS  
ZGJEDHORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhori Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 79 “Afishimi i materialeve propagandistike” si dhe Udhëzimi Nr.6, datë 23 Mars 2021”Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”

**VENDOSA**

1. Përcaktimin e rrugëve të mëposhtme për afishimin prej partive politike të materialeve propagandistike për zgjedhjet e përgjithshme të datës 11 Maj 2025:

-Lagjia “Bulevardi 18 Shtatori”, Rruga Nacionale Gjirokaštër – Kakavie,

-Qendra e Fshatit “Picar”,

-Ura e Kardhiqit,

-Qendra e fshatit “Lazarat”,

-Rruga "Ura e Lumit" / "Çajup",

-Qendra e fshatit "Andon Poç"

-Rruga "Ura e Lumit" Antigone.

2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të Bashkisë Gjirokastrë dhe një kopje e tij i dërgohet KQZ-së brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga miratimi i tij.

